LIGJ

Nr. 8934, date 5.9.2002

# PER MBROJTJEN E MJEDISIT

Ne mbështetje te neneve 59 shkronja "d" e pikës 1, 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 te Kushtetutës, me propozimin e Këshillit te Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

## KREU I

## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

### Neni 1
Qëllimi i ligjit

1. Ky ligj rregullon marrëdhëniet ndërmjet njeriut dhe mjedisit, mbron përbërësit e mjedisit dhe proceset mjedisore, siguron kushtet materiale për zhvillimin e qëndrueshëm, duke plotësuar kuadrin e nevojshëm për zbatimin e kërkesës kushtetuese për një mjedis ekologjikisht te pastër .
2. Ligji synon:
a) përdorimin racional te mjedisit dhe kufizimin e shkarkimeve e te ndotjeve ne te, parandalimin e dëmtimit te tij, rehabilitimin dhe shëndoshjen e mjedisit te dëmtuar;
b) përmirësimin e kushteve mjedisore, qe lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit te njeriut;
c) ruajtjen dhe mirëmbajtjen e burimeve natyrore, te përsëritshme dhe te papërsëritshme, administrimin racional dhe te frytshëm te tyre;
ç) bashkërendimin e veprimtarive shtetërore për te përmbushur kërkesat për mbrojtjen e mjedisit;
d) bashkëveprimin ndërkombëtar ne fushën e mjedisit;
dh) nxitjen dhe pjesëmarrjen e publikut ne veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit;
e) bashkërendimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror te vendit me kërkesat e zhvillimit te qëndrueshëm;
e) ngritjen dhe forcimin e rrjetit institucional te mbrojtjes se mjedisit ne nivel qendror dhe vendor.

### Neni 2
Fusha e zbatimit te ligjit

Mbrojtja e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për te gjitha organet shtetërore, personat fizike dhe juridike, vendas e te huaj, qe ushtrojnë veprimtarinë e tyre ne territorin e Republikës se Shqipërisë.

### Neni 3

Përkufizimi i termave

Ne kuptim te këtij ligji:

1. " Mjedis " është bashkësia e ndërveprimeve te përbërësve biotike dhe jobiotike qe nxisin dhe ushqejnë jetën e gjalle ne toke, duke përfshirë mjedisin biofizik natyror te ajrit, te tokës, te ujerave, larminë e ekosistemeve biologjike, shëndetin e njeriut, vlerat dhe trashëgimitë kulturore, shkencore, fetare e shoqërore.
2. "Mbrojtja e mjedisit" është veprimtaria qe synon parandalimin dhe kufizimin e ndotjes, te degradimit te mjedisit, përtëritjen, ruajtjen dhe përmirësimin e tij .
3. "Ndotja e mjedisit" është futja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e lendeve, vibracioneve, energjisë, nxehtësisë, rrezatimit, zhurmës e faktorëve biologjike ne ajër, ne ujë e ne toke, te cilat mund te ndryshojnë cilësitë e mjedisit dhe te dëmtojnë cilësinë e jetës.
4. "Dëmtimi i mjedisit" është prishja e karakteristikave fiziko-kimike dhe strukturore te ekosistemit natyror, ulja e prodhimtarisë biologjike dhe shumëllojshmërisë se ekosistemeve natyrore dhe antropike, prishja e ekuilibrit ekologjik dhe cilësisë se jetës te shkaktuara kryesisht nga ndotja e ujit, ajrit, tokës prej veprimtarive njerëzore ose fatkeqësive natyrore, si dhe nga mbishfrytezimi i burimeve natyrore dhe minerare.
5. "Shkarkimi ne mjedis" është çlirimi dhe dalja ne mjedis, ne mënyrë te drejtpërdrejtë ose te tërthortë, e lendeve te gazta, te ngurta, te lëngëta, si dhe energjisë, vibracioneve e zhurmave, nga një ose disa burime te palëvizshme, ne lëvizje ose te shpërndara.
6. "Lende te rrezikshme" janë ato lende, prodhimi, transporti, ruajtja, përdorimi e shkarkimi i te cilave ne mjedis, si rezultat i vetive te tyre, dëmtojnë ose mund te dëmtojnë shëndetin e njeriut, cilësitë e mjedisit, florën, faunën, biocenozat dhe biotopet.
7. "Mbetje" janë lendet, objektet ose pjese te tyre, qe përcaktohen nga autoriteti përgjegjës, te cilat nuk përdoren me ose qe pronari do t'i largoje. Mbetjet vlerësohen si te tilla, për sa kohe qe materialet e nxjerra prej tyre ose energjia e prodhuar nuk përfshihet ne procesin e prodhimit.
8. "Mbetje te rrezikshme" janë mbeturinat toksike gërryese, ngacmuese, shpërthyese, te përflakshme, kancerogjene, infektive dhe radioaktive, qe kane vetinë te prishin gjendjen natyrore te ujit, tokës dhe ajrit, me pasoja negative për shëndetin e njeriut dhe për ekosistemet natyrore.
9. "Treguesi mjedisor" është një ndryshore qe jep ne mënyrë te përmbledhur dhe te thjeshte te dhëna për një dukuri mjedisore, duke e bere atë te perceptueshme nëpërmjet dhënies se një vlere numerike, matjes dhe komunikimit. Dukuritë mjedisore lidhen me cilësitë e mjedisit e te përbërësve te tij, shkarkimet ne mjedis, ndotjen e mjedisit e dëmtimin e tij, biodiversitetin dhe shkallen e dëmtimit ose te ruajtjes se tij dhe masat e marra për mbrojtjen e mjedisit.
10. "Monitorimi i mjedisit" është grumbullimi, vlerësimi dhe përgjithësimi i te dhënave mjedisore me ane te vëzhgimit, te vazhduar ose periodik, te një grupi treguesish mjedisore, cilësore dhe sasiore, qe karakterizojnë përbërësit e mjedisit dhe ndryshimet e tyre nga ndikimi i faktorëve natyrore dhe njerëzore.
11. "Veprimtari qe ndikon ne mjedis" është çdo veprimtari ekonomike e shoqërore, qe përdor mjedisin ose përbërës te tij ose qe shkarkon ne mjedis lende dhe energji, duke ndryshuar cilësitë e tij .
12. "Ndikimi ne mjedis" është çdo ndryshim i mjedisit fizik, përfshirë pasojat shëndetësore, ekonomike, shoqërore, estetike, natyrore dhe fizike.
13. "Ndikimi ndërkufitar ne mjedis" është çdo ndikim ne një zone, qe ndodhet ne juridiksionin e një vendi, ku veprimtaria zhvillohet plotësisht ose pjesërisht ne një zone ne juridiksionin e një vendi tjetër, ku nuk përfshihen dukuritë e ndikimit ne mjedisin global (ndryshimet klimatike, ujerat ndërkombëtare, biodiversiteti, toka).
14. "Projekt" nënkupton:

a) zbatimin e veprave te ndërtimit, te instalimeve ose skemave;
b) ndërhyrjen ne mjedisin natyror dhe peizazh, duke përfshirë edhe shfrytëzimin e burimeve natyrore dhe te pasurive minerare.
15. "Vlerësimi i ndikimit ne mjedis" është procesi qe kryhet për te identifikuar , parashikuar, interpretuar, matur, komunikuar e parandaluar ndikimin e një projekti ne mjedis, sipas disa varianteve te tij, me qellim qe te përzgjidhet varianti me i mire për parandalimin dhe zbutjen e ndikimit negativ, para se projekti te miratohet dhe te zbatohet.
16. "Vlerësimi strategjik mjedisor" është procesi i vlerësimit te ndikimeve te mundshme ne mjedis te një politike, plani dhe programi.
17. "Deklarata mjedisore" është dokumenti zyrtar i lëshuar nga Ministri i Mjedisit pas shqyrtimit te kërkesës për miratimin e një projekti, plani ose programi te përcaktuar ne shkronjën "a" te pikës 14 te këtij neni, qe miraton ose jo kërkesën, duk e shoqëruar me kushte detyrimisht te zbatueshme për propozuesin dhe organet shtetërore përgjegjëse.
18. "Leja mjedisore" është dokumenti zyrtar i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, pas shqyrtimit dhe këshillimit me te gjitha palët e interesuara te kërkesës dhe dokumentacionit te saj shoqërues, qe miraton ushtrimin e çdo veprimtarie, qe ka ndikim ne mjedis, ku përcaktohen kushtet dhe rrethanat detyrimisht te zbatueshme, për te mos dëmtuar e ndotur mjedisin mbi normat e lejuara.
19. "Normat e cilësisë se mjedisit" janë një grup kërkesash, qe duhen plotësuar për një kohe te dhënë dhe ne një te dhënë pjese te mjedisit, për përmbajtjen e lendeve ndotëse, ne disa pika te veçanta te ajrit, ujerave dhe tokës, vlera e te cilave nuk duhet te kaloje vlerën kufi te lejuar
20. "Ndotja mbi norme e mjedisit" është tejkalimi i normave te cilësisë se mjedisit.
21. "Norma e shkarkimeve ne mjedis" është vlera me e madhe e lejuar e përmbajtjes se lendeve ndotëse ne shkarkimet për një periudhe kohe te dhënë, Normat e shkarkimeve zbatohen ne pikat ku shkarkimet dalin nga instalimi pa u holluar .
22. "Burime natyrore" janë elementet biotike dhe jobiotike, qe përdoren ose qe mund te përdoren nga njeriu për plotësimin e nevojave te tij .
23. "Burime te përteritshme" janë burimet natyrore, qe përtërihen ne mënyrë natyrore ose qe mund te përtërihen plotësisht ose pjesërisht me rruge te tjera. Te gjitha burimet e tjera janë te paperteritshme.
24. "Dëmtimi historik i mjedisit" është ndotja me lende te rrezikshme dhe mbetje e zonave industriale dhe e rrethinave te tyre, e shkaktuar nga veprimtaritë e ndërmarrjeve, te cilat sot mundte jene ne gjendje pune, te mbyllura, te braktisura, te privatizuara ose te dhe:na me koncesion dhe qe vazhdojnë te kërcënojnë shëndetin dhe mjedisin.
25. " Zhvillimi i qëndrueshëm" është zhvillimi qe plotëson nevojat e se tashmes dhe te se ardhmes pa shtrënguar ose prekur mundësitë dhe kapacitetet qe edhe brezat e ardhshëm te plotësojnë nevojat e tyre.
26. "Përdorimi i qëndrueshëm " i burimeve natyrore e minerare siguron plotësimin e nevojave te sotme, pa cenuar nevojat e brezave te ardhshëm për këto burime.
27. "Teknikat me te mira te mundshme" përfaqësojnë fazën me te përparuar dhe me nivel te larte te mbrojtjes se mjedisit, te zhvillimit te një veprimtarie dhe qe janë plotësisht te zbatueshme nga pikëpamja praktike dhe ekonomike.
28. "Parimi i kujdesit" është marrja e vendimeve dhe e veprimeve te nevojshme për te pakësuar rrezikun mjedisor, për te parandaluar dhe pakësuar ne kohen e duhur çdo dëmtim te ardhshëm te mjedisit.
29. "Parimi i parandalimit" është përzgjedhja dhe miratimi i variantit me te mire, qe ne fazën fillestare te vendimmarrjes, për te shmangur ndikime te dëmshme te një veprimtarie ne mjedis.
30. "Parimi i riaftësimit" është domosdoshmëria për te riparuar demet mjedisore te shkaktuara nga vete personat fizike e juridike dhe për te përtëritur dhe riaftësuar mjedisin e dëmtuar .

31. "Parimi "Ndotësi paguan"" nënkupton koston qe paguan ndotësi për përmirësimin e një mjedisi te ndotur dhe për kthimin e tij ne një gjendje te pranueshme. Kjo pasqyrohet në koston e prodhimit, te konsumit te mallrave dhe të shërbimeve qe shkaktojnë ndotjen.
32. "Instalimi" është një njësi teknike e palëvizshme, ku kryhen një ose me shume veprimtari ndotëse dhe veprimtari te tjera shoqëruese, qe kane lidhje teknike me veprimtaritë qe kryhen ne këtë zone dhe qe mund te kenë një ndikim ne shkarkimet dhe ndotjet ne mjedis. Instalimi ose veprimtaria është ekzistuese kur:
a) vepron ne përputhje me legjislacionin ekzistues përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji;
b) është ne procesin e dhënies se lejes mjedisore përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji;
c) është dhënë leja mjedisore dhe pritet te vihet ne pune jo me vone se një vit nga marrja e lejes mjedisore.
33. "Hedhje ne mjedis" është çdo derdhje, përhapje, pikim, rrjedhje, nxjerrje, shfryrje, shkarkim, zbrazje, injektim nëntokësor, rrëshqitje, shpëlarje, avullim, depozitim, duke përfshirë edhe braktisjen ose flakjen e fuçive, tankerëve dhe pajisjeve te tjera te mbyllura, mbartëse ose ambalazhuese.
34. "Transferim" është lëvizja e ndotësve jashtë vendit te prodhimit ose vendit ku mbahen, e kryer për përdorim, ripërdorim, magazinim, përpunim, rifitim energjie, riciklim ose depozitim.
35. "Burime te shpërndara" janë një grup burimesh te vogla, qe çlirojnë ndotës ne toke, ujë dhe ajër, ndikimi i kombinuar i te cilave është i rëndësishëm ne mjedisin pritës .
36. "Vlerësimi mjedisor" është rivlerësimi periodik i administrimit te mjedisit dhe mbrojtjes se tij, qe bëjnë personat fizike e juridike për instalime ose veprimtari te pajisura me leje mjedisore.
37. "Sistemi i administrimit mjedisor" përmbledh kuadrin institucional, politikat, planet e veprimit dhe masat tekniko-administrative për mbrojtjen e mjedisit, i certifikuar nga organizmat ndërkombëtare ISO dhe EMAS. 38. " Autoriteti publik i mbrojtjes se mjedisit" është Ministria e Mjedisit me organet dhe strukturat e veta, organet mjedisore ne institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore, si dhe çdo organ qendror dhe vendor qe krijohet ne vijim te tyre.
39. " Autoritete publike te administrimit te mjedisit" janë institucionet qendrore dhe organet e qeverisjes vendore, te cilat ngarkohen me ligj për administrimin e mjedisit dhe te përbërësve te tij .

Neni 4
Parimet baze te mbrojtjes se mjedisit

Mbrojtja e mjedisit mbështetet ne këto parime:
a) parimi i zhvillimit te qëndrueshëm;
b) parimi i kujdesit;
c) parimi i parandalimit;
ç) parimi "ndotësi paguan";
d)parimi i riparimit te dëmeve mjedisore, përtëritjes e riaftësimit te mjedisit te dëmtuar;
dh) parimi i përgjegjësisë ligjore;
e) parimi i mbrojtjes ne shkalle te larte;
e) parimi i integrimit te mbrojtjes se mjedisit ne politikat sektoriale;
f) parimi i ndërgjegjësimit dhe i pjesëmarrjes se publikut ne vendimmarrjen mjedisore;
g) parimi i transparencës ne vendimmarrjen mjedisore.

Neni 5
Elementet e mbrojtjes se mjedisit

Elementet kryesore strategjike te mbrojtjes se mjedisit janë:
a) parandalimi dhe ulja e ndotjes se ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve te tjera te çdo lloji;
b) ruajtja e shumëllojshmërisë biologjike sipas bazës natyrore, biogjeografike te vendit;
c) përdorimi racional i burimeve natyrore e minerare dhe shmangia e mbishfrytezimit te tyre;
ç) riaftësimi ekologjik i zonave te dëmtuara dhe te ndotura nga veprimtaria e njeriut dhe dukuritë natyrore shkatërruese;
d) ruajtja e ekuilibrit ekologjik dhe përmirësimi i cilësisë se jetës.

Neni 6
Rregullimi me dispozita te veçanta

Mbrojtja e ajrit, e burimeve natyrore dhe e pasurive minerare, e ujerave, e tokës dhe e pyjeve me ekosistemet përkatëse, e kullotave, e zonave te mbrojtura, administrimi i lendeve dhe mbetjeve te rrezikshme, i mbetjeve te ngurta dhe te lëngëta, i zonës bregdetare dhe mjedisit detar, ruajtja e natyrës dhe biodiversitetit, rregullohen me ligje te veçanta.

KREU II
POLITIKAT MJEDISORE

Neni 7
Politika shtetërore për mjedisin

1. Politika shtetërore për mbrojtjen e mjedisit synon zbatimin e kërkesave te Kushtetutës se Republikës te Shqipërisë për mjedisin. Ne hartimin dhe zbatimin e saj angazhohen te gjitha organet shtetërore, secili ne linjën e vet.
2. Strategjia kombëtare, strategjitë e veçanta sektoriale ose për përbërës te mjedisit, planet kombëtare e vendore te veprimit për mjedisin, janë dokumentet e politikes shtetërore për mjedisin.
3. Organet shtetërore te ngarkuara me ligj për administrimin e përbërësve te mjedisit ne politikat sektoriale, kombëtare e vendore, si transport, energji, bujqësi, turizëm, industri, shërbime, rregullim territori e zhvillim ekonomik e shoqëror, ne tërësi, sigurojnë harmonizimin e zhvillimit ekonomik e shoqëror me mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë se jetës.

Neni 8
Strategjitë dhe programet mjedisore

1. Strategjia dhe plani kombëtar i veprimit për mjedisin dhe për përbërësit e tij miratohen me vendim te Këshillit te Ministrave, me propozimin e Ministrit te Mjedisit. Strategjia për mbrojtjen e mjedisit hartohet për një periudhe te paktën dhjetëvjeçare.
2. Ne fund te çdo viti, Ministri i Mjedisit paraqet për shqyrtim ne Këshillin e Ministrave raportin vjetor te zbatimit te strategjisë dhe te planit te veprimit për mjedisin.

Neni 9
Strategjitë sektoriale

1. Strategjitë sektoriale dhe planet e veprimit me karakter kombëtar hartohen ne përputhje me parimet dhe përparësitë e strategjisë kombëtare te mjedisit.

2. Strategjitë, planet dhe programet për zhvillimin e ekonomisë dhe te degëve te saj ne nivel kombëtar, rajonal, qarku ose bashkie, sigurojnë integrimin e kërkesave te mbrojtjes se mjedisit, ne përputhje me strategjinë kombëtare te mjedisit.
3. Miratimi i dokumenteve te pikave 1 dhe 2 te këtij neni behet me vendim te Këshillit te Ministrave, vetëm nëse deklarata mjedisore është pozitive.

Neni 10
Planet vendore për mjedisin

1. Organet e qeverisjes vendore hartojnë plane veprimi për mjedisin, ne përputhje me përparësitë dhe kërkesat e strategjisë kombëtare te mjedisit.
2. Ministritë e linjës ndihmojnë ne hartimin dhe zbatimin e planeve vendore për mjedisin, duke paraqitur te dhënat e nevojshme dhe ekspertizën teknike.
3. Ne hartimin dhe miratimin e planeve dhe te programeve mjedisore, organet e qeverisjes vendore angazhojnë publikun dhe organizatat jofitimprurëse mjedisore dhe profesionale te biznesit.
4. Kryetaret e bashkive, ne fund te çdo viti, raportojnë ne këshillin e qarkut për zbatimin e planit vendor për mjedisin.

KREU III

PERDORIMI DHE MBROJTJA E PËRBËRËSVE TE MJEDISIT

Neni 11
Mbrojtja e barabarte

Përbërësit e mjedisit mbrohen dhe ruhen veçmas, si dhe te lidhur ngushte me njeri-tjetrin, ne ndërveprimin dhe integritetin e tyre. Mbrojtja e përbërësve te mjedisit përfshin mbrojtjen e barabarte te cilësisë, sasisë, burimeve te secilit dhe te përpjesëtimeve ndërmjet tyre.

Neni 12
Mbrojtja e tokës

1. Mbrojtja e tokës siguron mbrojtjen e funksioneve te saj natyrore ne mënyrë te qëndrueshme. Ajo përfshin sipërfaqen dhe shtresën nen sipërfaqësore, dheun, shkëmbinjtë dhe mineralet, format natyrore ose kalimtare, pjellorinë dhe strukturën e tokës, bilancin ujor, si dhe florën dhe faunën tokësore.
2. Përdorimi i tokës për qëllime bujqësore, blegtorale, për akuakulture, për transport mbi dhe nëntokësor, shfrytëzimi i pasurive minerare dhe rezervave natyrore te saj, si dhe çdo veprimtari e instaluar ne te, janë te detyruara te mos ndotin token mbi normat e lejuara, te mos shkaktojnë ndryshime te dëmshme ne sasinë e cilësinë e saj dhe ne ekosistemet e lidhura me re.
3. Depozitimi i lendeve dhe mbeturinave ne toke kryhet ne mënyrë te tille qe te shmange ndotjen dhe dëmtimin e saj.
4. Personi fizik dhe juridik qe ka përdorur token, pas përfundimit te veprimtarisë, është i detyruar ta sjelle atë ne gjendjen e mëparshme.

Neni 13
Mbrojtja e shtresës se humusit

1. Shtresa e humusit vendoset ne mbrojtje te veçante.
2. Ministri i Mjedisit, ne bashkëpunim me Ministrin e Bujqësisë dhe Ushqimit përcaktojnë kriteret, rregullat dhe masat për mbrojtjen e shtresës se humusit.

Neni 14
Mbrojtja e ujit

1. Mbrojtja e ujit përfshin ujerat sipërfaqësore dhe nëntokësore, burimet e tyre, sasinë dhe cilësinë, shtretërit dhe brigjet e ujerave sipërfaqësore dhe formimet akulltve.
2. Mbrojtja e ujit siguron parandalimin e dëmtimit te cilësisë se ujerave sipërfaqësore dhe tejkalimin e normave respektive te cilësisë, përmirësimin e cilësisë se ujerave sipërfaqësore te ndotura dhe arritjen e objektivave për cilësinë e ujit, parandalimin e shkatërrimit te cilësisë se ujerave nëntokësore, rehabilitimin e ujerave nëntokësore te ndotura, përmirësimin e bilancit ndërmjet shkalles se ekstraktimit dhe ripërtëritjes natyrore te ujerave nëntokësore, mbrojtjen e florës dhe faunës ujore.

Neni 15
Kriteret mjedisore për përdorimin e burimeve ujore

Kriteret kryesore mjedisore për përdorimin e burimeve ujore janë:
1. Shpejtësia e rrjedhjes natyrore, drejtimi i rrjedhjes, qarkullimi, shtrati dhe brigjet e ujerave ndryshohen vetëm duke mbajtur raporte te përshtatshme te biocenozës ujore dhe duke siguruar kushtet për funksionimin e saj.
2. Veprimtaritë qe kane te bëjnë me përdorimin e ujit, veçanërisht me përdorimin ne vepra hidraulike dhe hidroteknike, sigurojnë qe ujerat:
a) te mbeten një faktor peizazhformues, te mos shkaktojnë asnjë rënie te tyre dhe te ruajnë ekosistemet ujore;
b) te jene ne gjendje te rrisin faunën dhe florën ujore dhe tokësore dhe te mbrojnë speciet e rralla;
c) te sigurojnë, nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, kushte për te mundësuar përdorimin e tyre te mëtejshëm.
3. Për burimet natyrore qe furnizojnë sistemet e ujit te pijshëm, për ujerat qe përdoren ne industrinë ushqimore, për ujerat minerale dhe mjekësore, për ujerat qe janë te rëndësishme për ruajtjen e natyrës, si dhe për ujera te caktuara për çlodhje, sporte dhe përdorime mjekësore kurative, sigurohet mbrojtje e veçante. Ministri i Mjedisit, ne bashkëpunime te veçanta me Ministrin e Shëndetësisë, me Ministrin e Industrisë dhe Energjetikes, me Ministrin e Bujqësisë dhe Ushqimit, me Ministrin e Rregullimit te Territorit dhe Turizmit dhe me Ministrin e Kulturës, Rinise dhe Sporteve, miraton kriteret për kategorizimet e mësipërme te ujerave, si dhe përcakton rregullat, procedurat dhe masat e përdorimit dhe te mbrojtjes se tyre mjedisore.
4. Përdorimi i ujerave, shkarkimet ne ujera, si dhe shkarkimi i ujerave te përdorura, te përpunuara ose jo, bëhen ne mënyrë te tille qe te mos rrezikojnë kushtet e proceseve natyrore dhe ripërtëritjen sasiore e cilësore te tyre.
5. Tërheqja e ujit, kthimi i tij ne ujerat mëmë dhe transferimi nderbasenal, te mos cenojnë rezervat, te mos ndryshojnë ne mënyrë te pafavorshme cilësinë dhe pasuritë biologjike te burimit ujor e te mjedisit pritës, si dhe te mos rrezikojnë vetëpastrimin e ujit.
6. Veprimtaritë industriale, qe shkarkojnë ujera te përdorura, te parashikojnë gjate projektimit dhe te ndërtojnë para fillimit nga puna, stacione te trajtimit te ujerave te ndotura.

Neni 16

Mbrojtja e ajrit

1. Mbrojtja e ajrit përfshin atmosferën, proceset, përbërjen e saj dhe klimën. Mbrojtja mjedisore e ajrit rregullohet me ligj te veçante.
2. Mbrojtja e ajrit siguron mbrojtjen e shëndetit te njeriut, te kafshëve dhe te bimëve, bashkësive dhe habitateve te tyre, vlerat, natyrore dhe kulturore, nga ndikimet negative te ajrit te ndotur; parandalimin e dëmtimit dhe kërcënimit te shoqërisë nga cilësia e përkeqësuar e ajrit atmosferik, nga pakësimi i shtresës se ozonit dhe nga ndryshimet klimatike qe rrjedhin nga veprimtaritë njerëzore; mbrojtjen e cilësisë se ajrit atmosferik ne zonat ku nuk është dëmtuar dhe përmirësimin e tij ne zonat e tjera.

Neni 17
Pajisjet ozonholluese

1. Importimi dhe prodhimi i pajisjeve qe përdorin lende ozonholluese është i ndaluar .
2. Lista e pajisjeve qe ndalohen te prodhohen e te importohen, sepse përdorin lende ozonholluese, si dhe rregullat e procedurat e zëvendësimit te lendeve ozonholluese ne pajisjet ekzistuese, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit te Mjedisit.

Neni 18
Mbrojtja e biodiversitetit

1. Mbrojtja e biodiversitetit përfshin te gjithë organizmat e gjalle, biocenozat dhe habitatet e tyre.
2. Flora dhe fauna mund te përdoren vetëm nëse nuk dëmtohen proceset natyrore, kushtet e biocenozës dhe biodiversitetit, si dhe nuk rrezikohen funksionet e tyre për te siguruar zhvillimin e qëndrueshëm te popullatave ne mjedisin e tyre natyror .

Neni 19
Mbrojtja e mjedisit te ndërtuar nga njeriu

1. Mbrojtja e mjedisit te ndërtuar nga njeriu përfshin qendrat e banimit, ndërtimet individuale dhe strukturat tekniko-inxhinierike, monumentet historike e kulturore, zonat turistike, sipërfaqet e gjelbra dhe pyjore brenda dhe rreth qendrave te banimit.
2. Mjedisi i ndërtuar nga njeriu mbështetet ne plane kombëtare, rajonale e vendore zhvillimi, qe sigurojnë mbrojtjen e mjedisit, vlerat turistike, historike dhe kulturore, kapacitetet mbajtëse nga pikëpamja mjedisore dhe funksionet e synimet për te cilat ndërtohen.

Neni 20
Administrimi i mbetjeve

Administrimi i mbetjeve synon parandalimin dhe kufizimin e ndikimeve te tyre te dëmshme ne shëndetin e njeriut dhe ne mjedis. Administrimi i mbetjeve synon :
1. Parandalimin e krijimit te mbetjeve dhe trajtimin e tyre, duke përdorur teknika e teknologji te përparuara qe sigurojnë:
a) përdorimin e qëndrueshëm te burimeve;
b) prodhimin e produkteve, qe nuk rrezikojnë me mbetje dhe ndotje;
c) depozitimin përfundimtar te përshtatshëm te lendeve te rrezikshme, qe ndodhen ne mbetje, si dhe mundësitë për riciklimin e përpunimin e tyre.
2. Riciklimin, ripërdorimin ose rigjenerimin e mbetjeve ne procese te tjera.

Neni 21
Detyrimet e personave fizike dhe juridike për mbetjet

Personat fizike dhe juridike, veprimtaritë e te cilëve krijojnë ose përpunojnë mbetje, detyrohen te përdorin teknika dhe procese, qe nuk paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut, për ujerat, ajrin, token, bimët dhe kafshët, qe nuk shkaktojnë zhurma, ndotje shtese ose ere te keqe dhe qe nuk dëmtojnë ne mënyrë te pakthyeshme natyrën ose qëllimin e veçante te zonës ku veprojnë.

Neni 22
Importimi i lendeve dhe mbetjeve te rrezikshme

1. Ne Republikën e Shqipërisë ndalohet importimi i lendeve dhe i mbetjeve te rrezikshme, i mbetjeve dhe mbeturinave te tjera, me qellim ruajtjeje, depozitimi ose asgjësimi.
2. Lista e lendeve dhe e mbetjeve te rrezikshme, e mbetjeve dhe mbeturinave te tjera, për te cilat ndalohet importimi sipas pikës 1 te këtij neni, miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit te Mjedisit.
3. Importimi i çdo lloj mbetjeje me qellim përdorimi, përpunimi e riciklimi behet me vendim te Këshillit te Ministrave, sipas rregullave, procedurave, sasive dhe afateve te miratuara prej tij, me propozimin e Ministrit te Mjedisit.

Neni 23
Transportimi transit

Transportimi transit i mbetjeve dhe i lendeve te rrezikshme përmes territorit dhe ujerave territoriale e te brendshme te Republikës se Shqipërisë, lejohet vetëm nëse parashikohet ne një akt ndërkombëtar, ku Republika e Shqipërisë është pale. Ne këto raste, transportimi transit behet me leje te Këshillit te Ministrave, ne përputhje me rregullat e sigurimit te miratuara prej tij dhe te propozuara nga Ministri i Mjedisit, ne bashkëpunim me ministrat përkatës, sipas llojit te lendeve dhe mbetjeve te rrezikshme.

Neni 24
Lendet e rrezikshme

Prodhimi, përdorimi, ruajtja, transportimi i lendeve te rrezikshme, si dhe administrimi i teknologjive te rrezikshme rregullohen me ligj te veçante.

Neni 25
Tarifat dhe taksat mjedisore

1. Përdorimi i përbërësve te mjedisit për plotësimin e nevojave vetjake është falas, me përjashtim te rasteve ku me ligj shprehet ndryshe.
2. Përdorimi i përbërësve te mjedisit, për qëllime fitimi, i nënshtrohet pagesës se tarifës për përdorimin e burimeve natyrore ose pasurive minerare, siç është parashikuar ne ligje te veçanta.
3. për përdorimin e produkteve me fuqi te larte ndotjeje dhe për shkarkimet ne ajër, ujë dhe toke, personat fizike dhe juridike u nënshtrohen taksave mjedisore.

4. Produktet dhe ndotësit, për te cilët zbatohet taksa mjedisore, lloji dhe masa e saj, procedurat dhe rregullat e vjeljes e te përdorimit te saj për mbrojtjen e mjedisit rregullohen me ligj te veçante.

## KREU IV
## VLERESIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS

### Neni 26
### Procesi i vlerësimit te ndikimit ne mjedis

1. Projektet publike dhe private te personave fizike dhe juridike, vendas ose te huaj, qe kërkojnë te ushtrojnë veprimtari ne territorin e Republikës se Shqipërisë dhe qe mund te ndikojnë ne mjedis, i nënshtrohen vlerësimit te ndikimit ne mjedis, përpara miratimit dhe zbatimit te tyre.
2. Personi fizik ose juridik qe synon te realizoje një projekt ose veprimtari, fillimisht komunikon me organet e qeverisjes vendore, me publikun dhe organizatat jofitimprurëse mjedisore vendore, te cilave u paraqet, ne jo me pak se dy variante, llojin e veprimtarisë qe do te zhvillojnë, kapacitetin, teknologjinë, ndikimet ne mjedis dhe masat për zbutjen e tyre. Këto komunikime dhe qëndrimet paraprake te organeve te qeverisjes vendore, te publikut e te organizatave jofitimprurëse, kërkuesi i pasqyron ne dokumentet qe shoqërojnë kërkesën e tij .
3. Dokumentacioni qe shoqëron kërkesën për miratimin e projektit përmban: përshkrimin e projektit, te dhënë për zonën, projektin teknik, përshkrimin e masave për te shmangur, pakësuar dhe rehabilituar pasojat negative ne mjedis, te dhënat e nevojshme për identifikimin dhe matjen e ndikimeve qe mund te kenë ndaj mjedisit, variante te ndryshme, te dhëna te tjera te kërkuara nga organi përgjegjës. Kërkuesi mban përgjegjësi për vërtetësinë e dokumentacionit qe ka paraqitur .
4. Pas shqyrtimit paraprak te kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, organi përgjegjës, kur e sheh te nevojshme, kërkon plotësimin e tyre nga propozuesi dhe e pranon zyrtarisht për shqyrtim, vetëm pasi është bindur se dokumentacioni përkatës është ne përputhje me kërkesat e ligjit.
5. Projektet qe i nënshtrohen procesit te vlerësimit te ndikimit ne mjedis, kriteret e përzgjedhjes se tyre, procedurat e kërkimit dhe te realizimit te tyre, procedurat e shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur, marrja e vendimeve dhe ndjekja e zbatimit te projekteve te miratuara, përcaktohen me ligj te veçante.

### Neni 27
### Vlerësimi i ndikimit ne mjedis ne kontekst ndërkufitar

1. Kur projektet, qe i nënshtrohen vlerësimit te ndikimit ne mjedis, mund te kenë ndikim ne mjedisin e një vendi fqinj, Republika e Shqipërisë zbaton parimet e Konventës se Komisionit Ekonomik te Kombeve te Bashkuara për Evropën për vlerësimin e ndikimit ne mjedis ne kontekst ndërkufitar, ku ajo është pale, si dhe çdo parim tjetër te përgjithshëm dhe norma te se drejtës ndërkombëtare mjedisore.
2. Procedurat e kryerjes se vlerësimit te ndikimit ne mjedis ne kontekst ndërkufitar rregullohen me ligj te veçante.

### Neni 28
### Vlerësimi strategjik mjedisor

Politikat, strategjitë dhe planet e zhvillimit te transportit, te energjisë, bujqësisë, turizmit, industrisë, shërbimeve, te rregullimit te territorit e te zhvillimit ekonomik e shoqëror ne tërësi, i nënshtrohen vlerësimit strategjik mjedisor, procedurat e te cilit miratohen me ligj te veçante.

Neni 29
Projekte te sigurisë kombëtare

1. Projektet e fushës se mbrojtjes dhe te sigurisë kombëtare, qe u nënshtrohen proceseve te vlerësimit te ndikimit ne mjedis ose te vlerësimit strategjik mjedisor, përjashtohen nga këshillimi me publikun për te siguruar ruajtjen e sekretit.
2. Organi qe propozon dhe zbaton projektin, përgjigjet për zbatimin e kushteve te deklaratës mjedisore ose te lejes mjedisore, me te cilën është miratuar projekti.

Neni 30
Organi përgjegjës

Ministria e Mjedisit është organi përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesës dhe te dokumentacionit te hartuar gjate kryerjes se proceseve te vlerësimit te ndikimit ne mjedis dhe vlerësimit strategjik mjedisor, si dhe për dhënien e vendimit nëpërmjet deklaratës mjedisore dhe lejes mjedisore.

Neni 31
Specialistet qe shqyrtojnë dokumentacionin

1. Ministri i Mjedisit, kur e sheh te nevojshme, për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit te proceseve te vlerësimit te ndikimit ne mjedis dhe te vlerësimit strategjik mjedisor, cakton persona fizike e juridike, vendas ose te huaj, si specialiste te jashtëm, me përvojë ne fushën e parashikimit dhe te identifikimit te ndikimit ne mjedis, te cilët nuk kane lidhje kontrakture me kërkuesin. Oponenca e tyre vlerësohet nga organi përgjegjës.
2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit te Mjedisit dhe te Ministrit te Financave, përcakton rregullat dhe masat e shpërblimit për specialistet.
3. Ministri i Mjedisit miraton kërkesat e personave fizike e juridike, për njohjen e tyre si specialiste për vlerësimin e ndikimit ne mjedis dhe auditimin mjedisor, sipas rregullave, procedurave e kritereve, qe miratohen me vendim te Këshillit te Ministrave.

Neni 32
Përballimi i shpenzimeve

Shpenzimet e kryerjes se proceseve te vlerësimit te ndikimit ne mjedis dhe te vlerësimit strategjik mjedisor përballohen nga kërkuesi.

Neni 33
Palët e interesuara

1. Ne proceset e vlerësimit te ndikimit ne mjedis dhe te vlerësimit strategjik mjedisor marrin pjese te gjitha palët e interesuara, veçanërisht organet e qeverisjes vendore, publiku dhe organizatat jofitimprurëse mjedisore.

2. Gjate këtyre proceseve, organi përgjegjës ve ne dispozicion te publikut për këshillim, për një periudhe te mjaftueshme kohe, dokumentacionin e paraqitur nga kërkuesi.
3. Gjate marrjes se vendimit, organi përgjegjës merr parasysh mendimin e organeve te qeverisjes vendore, te publikut dhe te organizatave jofitimprurëse.

## KREU V

## LEJA PER VEPRIMTARITE QE NDIKOJNE NE MJEDIS

### Neni 34
### Detyrimi për marrjen e lejes

1. Personat fizike dhe juridike, vendas ose te huaj, janë te detyruar te marrin miratimin nga organet përgjegjëse, te caktuara ne këtë ligj për zhvillimin e veprimtarive, qe ndikojnë ose mund te ndikojnë ne mjedis.
2. Personi fizik ose juridik paraqet kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për te marre miratimin.
3. Miratimi i kërkesës behet me paraqitjen e deklaratës mjedisore, te lejes mjedisore, me pëlqimin ose autorizimin, sipas rasteve te specifikuara ne këtë ligj.
4. Deklarata mjedisore, leja mjedisore, pëlqimi dhe autorizimi, janë dokumente zyrtare, qe përcaktojnë kushtet dhe rrethanat ne te cilat do te zhvillohet veprimtaria e miratuar, për parandalimin dhe pakësimin e ndikimeve te saj ne mjedis.

### Neni 35
### Deklarata mjedisore

1. Pas shqyrtimit te dokumentacionit dhe këshillimit me palët e interesuara për projektet, strategjitë, planet e zhvillimit, Ministri i Mjedisit shpall qëndrimin zyrtar me deklaratën mjedisore.
2. Deklarata mjedisore përmban arsyetimin teknik dhe mbështetjen ligjore, jep argumentet përkatëse dhe masat qe duhen marre për te shmangur dhe pakësuar ndikime me te mëdha ne mjedis.
3. Kur deklarata mjedisore është negative, projekti, strategjia ose plani i zhvillimit nuk miratohen nga organet përkatëse vendimmarrëse. Kur deklarata mjedisore është pozitive, miratimi nga këto organe behet ne përputhje me përmbajtjen dhe kushtet e deklaratës.
4. Nëse projekti nuk fillon te zbatohet brenda dy vjetëve nga data e miratimit, deklarata mjedisore behet e pavlefshme dhe procedura e aplikimit fillon nga e para.
5. Nëse zbatimi i projektit kryhet ne përputhje me deklaratën mjedisore dhe lejen e ndërtimit, organi përgjegjës e pajis me lejen mjedisore përkatëse, ne përputhje me kërkesat e këtij ligji.
6. Deklarata mjedisore behet publike.

### Neni 36
### Leja mjedisore

1. Shfrytëzimi i pasurive minerare e i burimeve natyrore, vënia ne pune e instalimeve për shfrytëzimin dhe përpunimin teknologjik te tyre dhe veprimtaritë e tjera qe ndikojnë ne mjedis, për te cilat kërkohet leje mjedisore, përcaktohen me vendim te Këshillit te Ministrave, me propozimin e Ministrit te Mjedisit.
2. Me leje mjedisore pajisen edhe zgjerimet dhe rikonstruksionet, nëse këto përfaqësojnë

ndryshime themelore te kushteve gjate veprimtarive, si dhe mbyllja dhe çmontimi i veprimtarive e instalimeve. Ministri i Mjedisit propozon veprimtari te reja, qe duhet te pajisen me leje mjedisore.
3. Leja mjedisore jepet, hiqet, rishihet e ndryshohet nga Ministri i Mjedisit, vetëm ne kushtet e parashikuara ne këtë ligj. Leja mjedisore hiqet nga Ministri i Mjedisit me propozimin e Kryeinspektorit te Mjedisit.
4. Nëse veprimtaria nuk fillon brenda një viti nga data e miratimit te lejes, ajo behet e pavlefshme dhe procedura e aplikimit fillon nga e para.

Neni 37
Dokumentacioni për leje mjedisore

1. Dokumentacioni për te kërkuar leje mjedisore dhe elementet qe përmban leja mjedisore përcaktohen me vendim te Këshillit te Ministrave.
2. Përcaktimi i kushteve dhe i kërkesave qe vendosen ne lejen mjedisore, mbështetet ne normat e shkarkimeve, ne normat e cilësisë dhe ne teknikat me te mira te mundshme, qe sigurojnë sasi me te vogla te shkarkimeve ne mjedis, përdorime te frytshme te burimeve dhe te energjisë dhe mbrojtje me te mire te mjedisit.

Neni 38
Afatet e shqyrtimit te kërkesës për leje mjedisore

1. Leja mjedisore jepet brenda 3 muajve nga paraqitja e kërkesës dhe është e vlefshme qe nga koha kur fillon veprimtaria derisa kushtet, mbi te cilat është dhënë, nuk ndryshojnë.
2. Organi përgjegjës mund ta zgjasë kohen e dhënies se lejes deri ne 6 muaj, kur del e nevojshme kryerja e ekspertizave tepër te kualifikuara. Nëse organi qe miraton lejen mjedisore, nuk jep përgjigje brenda afatit te mësipërm, leja quhet e miratuar .
3. Shtyrjet e afatit për shkak te mangësive ne dokumentacionin e paraqitur nuk llogariten për efekt te pikave 1 dhe 2 te këtij neni.

Neni 39
Palët ne proces

1. Procesi i shqyrtimit te kërkesës për dhënien e deklaratës dhe te lejes mjedisore është i hapur për te gjitha palët e interesuara, duke përfshirë edhe shtete, ne rast ndikimi ndërkufitar ne mjedis.
2. Ministria e Mjedisit njofton dhe siguron mundësi te barabarta, gjate një muaji, për te gjitha palët e interesuara te procedurës se aplikimit, qe te njihen me dokumentacionin, deklaratën dhe lejen mjedisore.
3. Vendimi për miratimin ose jo te kërkesës behet publik,
4. Personat fizike dhe juridike, publiku dhe organizatat jofitimprurëse mjedisore, mund te ankohen ne gjykatën e rrethit brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit.

Neni 40
Përtëritja e lejes mjedisore

1. Leja mjedisore për shfrytëzim mineralesh dhe burimesh natyrore përtërihet çdo tre vjet.
2. Leja mjedisore për veprimtaritë e tjera përtërihet jo me vone se 5 vjet nga koha e lëshimit te saj .

Neni 41
Ndryshimi i lejes mjedisore

1. Organet qe japin lejen mjedisore e rishohin, e ndryshojnë ose e heqin atë ne çdo kohe nëse:
a) shfaqen elemente te reja ekologjike te panjohura ne kohen e dhënies se saj;
b) dalin dispozita te reja për mjedisin, qe e kërkojnë shprehimisht ndryshimin e saj;
c) vërtetohet ndotje tej normave te lejuara;
ç) ka ndryshime themelore te veprimtarisë;
d) ka përparime ne fushën e teknikave me te mira te mundshme, qe lejojnë pakësimin e rëndësishëm te shkarkimeve ne mjedis dhe qe nuk kërkojnë shpenzime te mëdha;
dh) ndryshohet kërkesa e sigurimit teknik, duke përdorur teknika te tjera me te mira.
2. Personit fizik dhe juridik qe nuk ka zbatuar kërkesat e një vendimi te Inspektoratit te Mjedisit, nuk i përtërihet leja mjedisore, për sa kohe qe këto kërkesa nuk plotësohen prej tij.

Neni 42
Ndryshimi i pronësisë

Kur veprimtaria e pajisur me leje mjedisore kalon ne pronësi ose ne përdorim te një personi tjetër fizik ose juridik, ky i fundit zbaton kërkesat e lejes ekzistuese te mjedisit.

Neni 43
Tarifa e shërbimit

1. Personat fizike e juridike qe pajisen me leje mjedisore, paguajnë një tarife shërbimi, qe caktohet nga Ministri i Mjedisit. Tarifa derdhet ne llogarinë e organit qe ka dhënë lejen.
2. Projektet dhe nismat, qe kryhen për mbrojtjen e mjedisit ose qe jepen si ndihme për Shqipërinë, përjashtohen nga tarifa e shërbimit për dhënien e lejes mjedisore dhe u krijohen lehtësi fiskale. Këto veprimtari dhe kriteret e përfitimeve te tyre përcaktohen me udhëzim te përbashkët te Ministrit te Mjedisit dhe Ministrit te Financave.

Neni 44
Detyrimi i lejes mjedisore

1. Veprimtaritë dhe instalimet qe ndikojnë ne mjedis nuk mund te fillojnë te ushtrohen ose te vihen ne pune pa marre lejen mjedisore.
2. Personat fizike dhe juridike nuk mund ta ushtrojnë veprimtarinë veçse ne përputhje me kushtet dhe kërkesat e vendosura ne lejet mjedisore.
3. Veprimtaritë qe ndikojnë ne mjedis, kur ushtrohen pa leje mjedisore, sipas rastit, pezullohen, mbyllen ose ndërpriten plotësisht ose pjesërisht nga Inspektorati i Mjedisit.

Neni 45
Pëlqimi dhe autorizimi

1. Veprimtaritë me karakter vendor, qe ndikojnë ne mjedis, por qe nuk përfshihen ne vendimin e Këshillit te Ministrave, te përmendura ne piken 1 te nenit 36 te këtij ligji, miratohen nga agjencitë rajonale te mjedisit, ne bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore. Miratimi për këto veprimtari jepet ne formën e pëlqimit ose te autorizimit.
2. Ministri i Mjedisit miraton sipas këtij neni listën e veprimtarive, formatin e aplikimit dhe rregullat e procedurat e dhënies se pëlqimit ose te autorizimit nga agjencitë rajonale te mjedisit.

Neni 46
Detyrime te përgjithshme

1. Gjate vënies ne pune te veprimtarive dhe instalimeve, personat fizike e juridike sigurojnë:
a) zbatimin e te gjitha masave qe parandalojnë shkarkimet mbi norme dhe ndotjen e mjedisit;
b) shmangien dhe pakësimin e mbetjeve dhe, aty ku përdorimi i tyre nuk është i mundur teknikisht ose ekonomikisht, neutralizimin e tyre, duke shmangur dhe pakësuar ndikimin ne mjedis;
c) parandalimin e aksidenteve industriale dhe kufizimin e pasojave te tyre;
ç) kthimin e vendit ne kushte te kënaqshme mjedisore pas përfundimit te veprimtarisë;
d) njoftimin për çdo ndryshim te planifikuar te linjës teknologjike;
dh) respektimin e kërkesave dhe te kushteve te lejes mjedisore;
e) njoftimin e agjencive rajonale te mjedisit, jo me rralle se një here ne 3 muaj, për rezultatet e vetemonitorimit dhe, ne çdo kohe, për aksidentet ose emergjencat me ndikim negativ ne mjedis;
ë) plotësimin e kërkesave te Inspektoratit te Mjedisit gjate kryerjes se kontrollit te veprimtarisë se tyre;
f) njohjen e publikut me gjendjen e mjedisit dhe profilin mjedisor te veprimtarisë se tyre;
g) mbajtjen e regjistrave për shkarkimet ne mjedis, për përdorimin e ujit dhe te energjisë, si dhe për teknikat e përdorura.
2. Kërkesat e këtij neni zbatohen si me poshtë:
a) për veprimtaritë dhe instalimet e reja, 1 vit pas hyrjes ne fuqi te ligjit;
b) për veprimtaritë ekzistuese, jo me shpejt se 2 vjet dhe jo me vone se 5 vjet pas hyrjes ne fuqi te ligjit.
3. Ministria e Mjedisit, ne bashkëpunim me ministritë e linjës, ndërmerr fushata ndërgjegjësimi për njohjen me kërkesat e këtij ligji.

Neni 47
Sistemet e certifikuara te administrimit mjedisor

1. Shteti nxit dhe përkrah zbatimin nga personat fizike dhe juridike te sistemeve te certifikuara te administrimit mjedisor .
2. Personave fizike dhe juridike, qe zbatojnë sisteme te certifikuara te administrimit mjedisor, u krijohen lehtësi procedurale ne procesin e vlerësimit te ndikimit ne mjedis dhe ne marrjen e lejes mjedisore, lehtësi qe përcaktohen me udhëzim te Ministrit te Mjedisit.

Neni 48
Vlerësimi mjedisor

1. Personat fizike dhe juridike kryejnë me shpenzimet e veta vlerësimin mjedisor te veprimtarive qe ushtrojnë jo me rralle se një here ne tre vjet. Vlerësimi mjedisor realizohet sipas metodologjisë se miratuar nga Ministri i Mjedisit
2. Ne përfundim te vlerësimit mjedisor te veprimtarisë se vet, personi fizik ose juridik bën publike rezultatet dhe njofton organet e qeverisjes vendore dhe agjencinë rajonale te mjedisit
3. Kur një veprimtari e pajisur me leje mjedisore ndot ose dëmton mjedisin, organet shtetërore, qendrore dhe vendore, publiku dhe organizatat jofitimprurëse mjedisore, i kërkojnë Ministrit te Mjedisit te urdhërojë kryerjen e vlerësimit mjedisor .
4. Ministri shpall qëndrimin e vet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës. Kundër këtij qëndrimi mund te behet ankim ne gjykatën e rrethit brenda 10 ditëve nga shpallja e tij.

## KREU VI
## PARANDALIMI DHE KUFIZIMI I NDOTJES SE MJEDISIT .

### Neni 49
### Parandalimi i aksidenteve industriale

1. Personat fizike dhe juridike, qe ne veprimtaritë e tyre përdorin lende te rrezikshme, detyrohen te ngrenë sistemin e parandalimit dhe te kontrollit te aksidenteve, për te shmangur pasojat për jetën, shëndetin e njeriut dhe për mjedisin.
2. Identifikimi i veprimtarive gjate te cilave përdoren lende te rrezikshme, kriteret e ngritjes se sistemeve te parandalimit dhe te kontrollit te aksidenteve, masat qe duhen marre, detyrimet e personave fizike e juridike, organet kontrolluese dhe përgjegjësitë e tyre, rregullohen me vendim te Këshillit te Ministrave, me propozimin e përbashkët te Ministrit te Mjedisit, Ministrit te Punës dhe çështjeve Sociale, Ministrit te Shëndetësisë dhe Ministrit te Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.

### Neni 50
### Normat mjedisore

1. Për te kontrolluar dhe parandaluar ndotjen dhe dëmtimin e mjedisit, vendosen normat e përdorimit te mjedisit, normat e cilësisë se mjedisit dhe normat e shkarkimeve ne mjedis.
2. Ne varësi te karakteristikave te mjedisit qe duhet mbajtur, te natyrës se ndotjes, përballimit te rasteve te emergjencës dhe mundësisë praktike për t'i respektuar, normat mjedisore janë kombëtare, te veçanta, për zonat qe kërkojnë mbrojtje te veçante, dhe te përkohshme.
3. Normat e cilësisë se mjedisit, te shkarkimeve ne mjedis dhe te përdorimit te mjedisit, miratohen me vendim te Këshillit te Ministrave, me propozimin e Ministrit te Mjedisit dhe Ministrit te Shëndetësisë.
4. Normat e veçanta, për zona qe kërkojnë mbrojtje te veçante, vendosen nga Ministri i Mjedisit, ne bashkëpunim me ministrat përkatës dhe organet e qeverisjes vendore.
5. Përcaktimi i vlerës se normave, si kufi i lejuar për përdorimin e mjedisit ose te përbërësve te tij, sasia, cilësia, përqendrimi i lendeve dhe i energjisë qe shkarkohen ne mjedis, mbështeten ne udhëzimet e Bashkimit Evropian, ne objektivat e politikes shtetërore mjedisore dhe ne teknikat me te mira te mundshme .

### Neni 51
### Normat e përkohshme për instalimet ekzistuese

1. Për instalimet ekzistuese, personat fizike e juridike paraqesin ne Ministrinë e Mjedisit, brenda 1 viti nga hyrja ne fuqi e normave mjedisore, programin qe do te zbatojnë për plotësimin e tyre.
2. Ne mbështetje te programit, Ministria e Mjedisit vendos afatet për zbatimin e normave te miratuara, te cilat nuk mund te zgjasin me tepër se 5 vjet nga hyrja ne fuqi e normave mjedisore.
3. për personat fizike e juridike, qe nuk e paraqesin programin, afati për zbatimin e normave mjedisore është 2 vjet pas hyrjes se tyre ne fuqi.
4. Gjate këtyre periudhave personat fizike e juridike zbatojnë normat mjedisore te përkohshme, te cilat çojnë ne përmirësime ne rritje te zbatueshmerise.
5. Nëse personat fizike e juridike nuk zbatojnë kushtet dhe kërkesat e këtij neni, veprimtaria e tyre pezullohet derisa te arrihet zbatueshmeria.

6. Normat e përkohshme dhe mënyrat për vendosjen e tyre miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit te Mjedisit.
7. Nëse pas zbatimit të normave të përkohshme vërehen dukuri qe rrezikojnë shëndetin dhe dëmtojnë rende mjedisin, Inspektorati i Mjedisit vendos pezullimin ose mbylljen e përhershme te veprimtarisë ose te impiantit ndotës.

## KREU VII

## MONITORIMI DHE TE DHENAT

### Neni 52
### Monitorimi i mjedisit

1. Monitorimi i mjedisit, i cili përfshin monitorimin e cilësive te tij, te ndotjes dhe te dëmtimit, te biodiversitetit, te dukurive natyrore dhe te shkarkimeve, është i detyrueshëm.
2. Monitorimi i cilësisë se mjedisit, i ndotjes dhe i dëmtimit te tij dhe biodiversitetit përfshin token, ujin, ajrin, florën e faunën dhe lidhjet e tyre me shëndetin.
3. Monitorimi i dukurive natyrore përfshin dukuritë meteorologjike, hidrologjike, te erozionit te tokës, sizmologjike, rrezatuese dhe dukuri te tjera gjeofizike natyrore.
4. Monitorimi i shkarkimeve përfshin te gjitha llojet dhe tipat e shkarkimeve, te shkaktuara nga veprimtaritë e ndryshme te personave fizike e juridike.

### Neni 53
### Programi kombëtar i monitorimit

1. Ministria e Mjedisit, ne bashkëpunim me organet qendrore dhe vendore, harton programin kombëtar te monitorimit, si dhe bashkërendon e kontrollon punën për zbatimin e tij. Ne mbështetje te te dhënave te nivelit te ndotësve, Ministria e Mjedisit propozon masa konkrete për mbrojtjen e pastërtisë se ajrit, te ujit, te tokës dhe fondit gjenetik te vendit.
2. Monitorimi i mjedisit realizohet ne përputhje me programin kombëtar te monitorimit, i cili përcakton treguesit e cilësisë se mjedisit, te shkarkimeve, te ndotjes dhe dëmtimit, te dukurive natyrore, te biodiversitetit, metodikat e marrjes se kampioneve, te matjeve, te përpunimit te te dhënave, si dhe raportimin e publikimin e tyre.
3. Monitorimi i dukurive natyrore dhe i cilësisë se mjedisit është detyre dhe përgjegjësi e organeve shtetërore dhe përballohet nga Buxheti i Shtetit.
4. Rrjetet kombëtare te monitorimit ndërtohen ne përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.
5. Matjet dhe testet laboratorike kryhen nga laboratorë te akredituar .
6. Monitorimi i shkarkimeve, i ndotjes e dëmtimit te mjedisit për shkak te veprimtarive njerëzore dhe kur është e nevojshme edhe i dukurive natyrore qe rezultojnë prej tyre, realizohet dhe përballohet nga personat fizike e juridike, te cilëve u përkasin veprimtaritë dhe instalimet, ne përputhje me lejet mjedisore.
7. Ministria e Mjedisit kontrollon cilësinë e monitorimit, te matjeve, zbatimin e metodikave, kualifikimin e specialisteve qe marrin pjese, pajisjet e përdorura dhe vërtetësinë e rezultateve.
8. Rregullat dhe procedurat për hartimin e programit kombëtar te monitorimit dhe për zbatimin e tij, për ngritjen e rrjeteve te monitorimit, miratohen me vendim te Këshillit te Ministrave, me propozimin e Ministrit te Mjedisit.

### Neni 54
### Te dhënat për mjedisin

1. Te dhënat për gjendjen e mjedisit përfshijnë:
a) te dhënat për gjendjen e përbërësve te mjedisit;
b) te dhënat për zhvillimin e sektorëve te ekonomisë, qe ndikojnë ne mjedis dhe faktorët e drejtpërdrejtë, qe ushtrojnë trysni ne mjedis;
c) te dhënat për ndikimin ne mjedis;
ç) te dhënat për veprimtaritë e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit;
d) te dhënat për gjendjen e shfrytëzimin e burimeve natyrore, biologjike, minerare dhe te energjisë;
dh) te dhënat qe përftohen nga zbatimi i programit kombëtar te monitorimit;
e) te dhënat për shkarkimet ne mjedis, për cilësinë e mjedisit dhe dukuritë natyrore.
2. Te dhënat shoqërohen me shpjegime rreth pasojave negative te mundshme, me veprim te vonuar mbi mjedisin dhe shëndetin, si dhe me rekomandimet për mënyrën e veprimit te shtetasve, ne rast vërtetimi te pasojave negative.

Neni 55
Grumbullimi i te dhënave

1 Të dhënat për gjendjen , mjedisit grumbullohen nga Ministria e Mjedisit dhe agjencitë rajonale nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore dhe organet e qeverisjes qendrore
2 Te dhënat mjedisore kërkohen, hartohen dhe paraqiten sipas rregullave e caktuara nga Ministri i Mjedisit . Personat fizike e juridike paraqesin te dhënat brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës.

Neni 56
Bërja publike e te dhënave

1. Organet shtetërore qe grumbullojnë te dhëna mjedisore, i bëjnë publike ato ne media dhe shtyp ose mjete te tjera te përshtatshme, ne një forme te kuptueshme për publikun.
2. Organet shtetërore dhe personat fizike e juridike sapo vërejnë ndotje ose dëmtim te mjedisit, njoftojnë popullsinë për ndryshimet mjedisore negative, për masat e marra për kufizimin ose mënjanimin e tyre dhe për mënyrën e veprimit te shtetasve për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë e tyre .
3. Personat fizike e juridike njoftojnë blerësit ose konsumatoret, ne kohen e shitjes ose te kryerjes se shërbimit, me shkrim ose me goje, për përbërësit e rrezikshëm te mallrave e te shërbimeve dhe për ndikimet negative ne mjedis dhe ne shëndet.
4. Te dhënat me karakter sekret për sigurimin kombëtar ose te konfidencialitetit tregtar kombëtar, administrohen sipas kërkesave te ligjit nr. 8457, date 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror" .

Neni 57
Sistemi kombëtar i te dhënave

1. Për te siguruar grumbullimin, përpunimin dhe bërjen publike te te dhënave mjedisore, Ministria e Mjedisit krijon sistemin kombëtar te te dhënave mjedisore. Ndërtimi dhe funksionimi i tij rregullohen me ligj te veçante.
2. Sistemi kombëtar i te dhënave mjedisore është i hapur për publikun.
3. Ministria e Mjedisit përgatit çdo 2 vjet raportin për gjendjen e mjedisit, i cili i paraqitet për miratim Këshillit te Ministrave. Raporti i miratuar behet publik përmes botimit ne shtyp ose përmes sistemeve elektronike .

4. Ministria e Mjedisit boton periodikisht buletinin e vet zyrtar dhe realizon botime te tjera për mjedisin.

Neni 58
Regjistrat e ndotësve

1. Ministria e Mjedisit harton regjistrin kombëtar për shkarkimet ne mjedis, për çlirimet dhe transferimet e ndotësve ne mjedis, për përdorimin e ujit, te energjisë elektrike dhe burimeve natyrore e minerare.
2. Regjistri kombëtar hartohet ne mbështetje te raportimit te rregullt nga personat fizike e juridike, nga organet e caktuara për grumbullimin dhe prodhimin e te dhënave mjedisore.
3. Regjistri kombëtar administrohet nga Ministria e Mjedisit dhe është i hapur për publikun.
4. Te dhënat e regjistrit kombëtar paraqiten ne formën qe siguron identifikimin e kontributeve te shkarkimeve, te çlirimeve dhe te transferimeve ne mjedis, për çdo instalim e ndotës, vendndodhjen dhe vendmbërritjen e tyre ne ajër, ujë e toke.
5. Forma, përmbajtja, afatet dhe mënyra e plotësimit, organi qe e administron dhe rregullat e përdorimit e te bërjes publike te tij përcaktohen me urdhër te Ministrit te Mjedisit.
6. Personat fizike e juridike shënojnë rregullisht te dhënat ne regjistra te veçante, te miratuar nga Ministria e Mjedisit. Ne mbështetje te këtyre regjistrimeve, ata raportojnë ne agjencitë rajonale te mjedisit dhe i botojnë te dhënat mjedisore çdo 3 muaj .

KREU VIII

KONTROLLI MJEDISOR

Neni 59
Kontrolli për gjendjen e mjedisit

1. Kontrolli për gjendjen e mjedisit qëndron ne mbikëqyrjen e elementeve dhe te faktorëve natyrore e njerëzore te mjedisit, ne vëzhgimin dhe regjistrimin e ndryshimeve te tyre dhe ne mbikëqyrjen e burimeve e te shkaqeve te këtyre ndryshimeve.
2. Te dhënat e mbledhura nga kontrolli shërbejnë për verifikimin e zbatimit te legjislacionit mjedisor, për te prodhuar te dhëna për gjendjen e mjedisit, për rishikimin ose heqjen e lejeve te mjedisit dhe për marrjen e masave te përcaktuara ne këtë ligj.
3. Kontrolli ushtrohet ne mënyrë te përhershme e te vazhdueshme, te përsëritshme, ne përputhje me parametrat, burimet dhe shkaqet e ndotjes ose te dëmtimit te mjedisit.

Neni 60
Organet qe ushtrojnë kontroll për mjedisin

1. Kontrolli për gjendjen e mjedisit është detyre e Inspektoratit te Mjedisit, e punonjësve te caktuar nga Ministri i Mjedisit dhe e agjencive rajonale te mjedisit.
2. Policia Pyjore, Policia e Ndërtimit, Inspektorati Sanitar, Inspektorati i Mbrojtjes se Bimëve, Inspektorati i Peshkimit, Inspektorati i Hidrokarbureve, Inspektorati Zooveteriner , inspektorati dhe organet e kontrollit te qeverisjes vendore, sipas njësive territoriale përkatëse, ushtrojnë kontroll për gjendjen e përbërësve te veçante te mjedisit, ne mbështetje te akteve normative qe rregullojnë veprimtarinë e organeve përkatëse.

Neni 61
Rregullimi i veprimtarisë se organeve te kontrollit për mjedisin

1. Organizimi dhe veprimtaria e Inspektoratit te Mjedisit rregullohen me vendim te Këshillit te Ministrave, me propozimin e Ministrit te Mjedisit. Bashkërendimi i punës me organet e tjera te kontrollit, shkëmbimi i te dhënave, kryerja e inspektimeve te përbashkëta rregullohen me udhëzim te përbashkët te ministrave përkatës.
2. Parametrat, objektet dhe mënyrat e ushtrimit te kontrollit, planet e hollësishme dhe ndërhyrjet me karakter te veçante, përgatiten nga Inspektorati i Mjedisit e agjencitë rajonale te mjedisit dhe miratohen nga Kryeinspektori i Mjedisit, sipas udhëzimit te miratuar nga Ministri i Mjedisit.
3. Për qëllime inspektimi dhe marrje kampionesh, gjate ushtrimit te kontrollit, inspektoret e mjedisit janë te autorizuar te hyjnë ne te gjitha vendet dhe mjediset, objekte te kontrollit.
4. Personat fizike e juridike, gjate kontrollit te veprimtarisë se tyre, krijojnë te gjitha kushtet për zhvillimin normal te kontrollit.

Neni 62
Shpenzimet e kontrollit

Shpenzimet e kontrollit për gjendjen e mjedisit, kur verifikohet ndotja ose dëmtimi i mjedisit, përballohen nga personi fizik e juridik, autor i ndotjes ose dëmtimit te mjedisit.

Neni 63
Vendimi i kontrollit

1. Ne mbështetje te kontrollit te ushtruar, Inspektorati i Mjedisit, sipas rastit, vendas mbylljen, ndalimin ose ndërprerjen e plote ose te pjesshme te veprimtarisë qe ka shkaktuar ndotje ose dëmtim te mjedisit, duke caktuar edhe detyrat për rregullimin e gjendjes. Rezultatet dhe vendimi i kontrollit bëhen publike.
2. Rregullat për administrimin e këtij procesi caktohen nga Ministri i Mjedisit.

KREU IX
DETYRA T E ORGANEVE SHTETERORE PER MJEDISIN

Neni 64
Rrjeti institucional mjedisor

1. Tërësia e organeve te specializuara, te ngarkuara me ligj për mbrojtjen e mjedisit ne Republikën e Shqipërisë, përfaqëson rrjetin institucional mjedisor shqiptar .
2. Rrjeti institucional mjedisor përbëhet nga Ministria e Mjedisit, nga agjencitë rajonale te mjedisit, nga Inspektorati i Mjedisit, nga organizmat mjedisore, ne përbërje te organeve qendrore e vendore dhe nga organizmat ndërministrore, te miratuar nga Këshilli i Ministrave për te ndjekur probleme te rëndësishme te fushës se mjedisit.
3. Organet shtetërore, qendrore dhe vendore, si administruese te ligjshme te pjesëve dhe përbërësve te ndryshëm te mjedisit, realizojnë mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet zbatimit te këtij funksioni.

Neni 65
Përcaktimi dhe ndarja e përgjegjësive

Organet shtetërore kryejnë detyrat për mbrojtjen e mjedisit ne baze te përcaktimit te përgjegjësive dhe te ndarjes se qarte te tyre ndërmjet organeve qendrore dhe vendore, duke zgjeruar ne vijimësi detyrat e organeve te qeverisjes vendore.

Neni 66
Ministri i Mjedisit

Veç përgjegjësive te përcaktuara ne Kushtetute, Ministri i Mjedisit ushtron edhe këto detyra ne fushën e mjedisit:
a) i kërkon kryeministrit pezullimin e miratimit te strategjive e te planeve sektoriale, kur ato nuk janë ne pajtim me deklaratën mjedisore;
b) cakton, ne bashkëpunim me ministrat përkatës, fondet për mjedisin ne çdo ministri dhe për përdorimin racional te tyre ne shkalle vendi;
c) përfaqëson vendin ne veprimtaritë ndërkombëtare, ne organizatat dhe programet ndërqeveritare dhe ndërshtetërore;
ç) miraton metodat dhe metodologjitë mbi te cilat zhvillohen veprimtaritë baze te mbrojtjes se mjedisit.

Neni 67
Ministria e Mjedisit

Si institucion qendror i specializuar për mbrojtjen e mjedisit dhe si mbështetëse teknike e Ministrit te Mjedisit, Ministria e Mjedisit kryen edhe këto detyra kryesore
a) bashkëpunon me institucionet qendrore, dhe organet e qeverisjes vendore, me publikun dhe organizatat jofitimprurëse mjedisore e profesionale, për te rritur shkallen e zbatimit te legjislacionit mjedisor;
b) përgatit projektet e marrëveshjeve, te protokolleve e programeve te bashkëpunimit dy e shumëpalësh, me shtete, organe dhe organizata ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit dhe ndjek zbatimin e tyre;
c) studion nevojat e vendit për specialiste për mbrojtjen e mjedisit dhe bashkërendon me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për kualifikimin e specializimin e tyre
ç) mbështet projekte për pune kërkimore-shkencore, për përmirësimin e gjendjes se mjedisit, për futjen e teknologjive ekologjikisht te pastra, për nxitjen e veprimtarive te organizatave jofitimprurëse mjedisore
d) ndihmon organet e qeverisjes vendore për mbrojtjen e mjedisit dhe për hartimin e zbatimin e planeve vendore për mjedisin

Neni 68
Këshillat e specialisteve

1. Për te mbështetur veprimtarinë e Ministrit te Mjedisit, pranë tij ngrihen e funksionojnë si organe këshillimore:
a) Këshilli Kombëtar i Mjedisit;
b) këshillat për politika mjedisore sektoriale.
2. Këshillat përbëhen nga personalitete te fushës se mbrojtjes se mjedisit te institucioneve kërkimore-shkencore e arsimore, te ministrive, te institucioneve qendrore dhe te organizatave jofitimprurëse .
3. Si organ këshillimor pranë prefektit, për te mbështetur administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit ne nivel qarku, ngrihet këshilli rajonal i mjedisit.

4. Përbërja, detyrat dhe funksionet e këtij këshilli, si dhe shpenzimet për ngritjen e funksionimin e tij, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit te Mjedisit.

Neni 69
Agjencitë rajonale te mjedisit

1 Agjencitë rajonale te mjedisit janë organe te specializuara për mbrojtjen e mjedisit, qe varen nga Ministria e Mjedisit dhe organizohen e veprojnë ne nivel qarku
2. Ne zbatim te përparësive dhe objektivave te Ministrisë se Mjedisit, agjencitë rajonale
a) realizojnë zbatimin e ligjshmërisë për mbrojtjen e mjedisit ne nivel vendor;
b) ndihmojnë organet e pushtetit vendor për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit qe kane ne juridiksion, bashkëpunojnë për hartimin dhe zbatimin e planeve vendore te veprimit për mjedisin;
c) nxisin përdorimin e teknologjive te pastra dhe futjen e sistemeve te administrimit mjedisor;
ç) marrin pjese ne procesin e miratimit te lejes dhe te deklaratës mjedisore, duke përmbushur detyrat qe përcakton Ministri i Mjedisit me udhëzim te veçante. Japin pëlqimin dhe autorizimin mjedisor për veprimtari vendore;
d) hartojnë dhe paraqesin për miratim ne këshillin e qarkut raportin dyvjeçar te gjendjes se mjedisit te qarkut Pas miratimit ky raport i behet i ditur publikut nëpërmjet medieve te shkruara dhe elektronike;
dh) ndërmarrin veprimtari ndërgjegjesuese për mjedisin, bashkëpunojnë me bashkësitë, me organizatat jofitimprurëse mjedisore dhe profesionale te biznesit.
3. Rregullat e hollësishme për organizimin, funksionimin dhe sistemimin e agjencive rajonale te mjedisit caktohen nga Këshilli i Ministrave,me propozimin e Ministrit te Mjedisit.

Neni 70
Inspektorati i Mjedisit

1. Pranë Ministrisë se Mjedisit funksionon Inspektorati i Mjedisit, si organ i specializuar kontrolli për mjedisin.
2. Inspektorati i Mjedisit përbëhet nga Kryeinspektori, nga inspektoret ne Ministrinë e Mjedisit dhe nga inspektoret e agjencive rajonale te mjedisit. Inspektoret ne Ministrinë e Mjedisit e ushtrojnë veprimtarinë kontrolluese ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë, ndërsa inspektoret e agjencive rajonale te mjedisit veprojnë brenda territorit te qarkut.
3. Veprimtaria e Inspektoratit te Mjedisit drejtohet nga Kryeinspektori i Mjedisit, i cili emërohet nga Ministri i Mjedisit.
4. Me propozimin e Kryeinspektorit, Ministri i Mjedisit përcakton kriteret për emërimin e inspektoreve.
5. Kryeinspektori emëron dhe shkarkon inspektoret.
6. Për vështirësitë e detyrës, inspektoret marrin si shpërblim mbi page një përqindje te gjobave qe vjelin, e cila miratohet me vendim te Këshillit te Ministrave, me propozimin e Ministrit te Mjedisit dhe te Ministrit te Financave.

Neni 71
Detyrat kryesore te Inspektoratit te Mjedisit

1. Inspektorati i Mjedisit:

a) ushtron kontroll te vazhdueshëm mbi mjedisin dhe ndaj veprimtarive ndotëse, për te siguruar mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet zbatimit te legjislacionit mjedisor dhe kërkesave te vena ne lejen dhe ne deklaratën mjedisore. Kontrollet kryhen nga grupe inspektoresh ose nga një inspektor i vetëm;
b) kërkon pjesëmarrjen e organeve te qeverisjes vendore, te përfaqësuesve te bashkise, te organizatave jofitimprurëse mjedisore dhe te medieve ne kontrollet mbi veprimtaritë ndotëse;
c) krijon dosjen mjedisore për çdo veprimtari te pajisur me leje mjedisore. Rregullat e hollësishme për formën, përmbajtjen, administrimin e dosjes mjedisore, përcaktohen nga Ministri i Mjedisit;
ç) ndihmon personat fizike e juridike për te realizuar vetemonitorimin, verifikimin dhe zbatimin e sistemeve te integruara te administrimit dhe kontrollon zbatimin e tyre;
d) urdhëron masa te detyrueshme për zbatim për përmirësimin e gjendjes se mjedisit, për pakësimin e ndotjes dhe te dëmtimit te mjedisit;
dh) ve ne dijeni rregullisht pushtetin vendor për gjendjen e mjedisit, për veprimtaritë, projektet dhe instalimet e miratuara, sipas kërkesave te këtij ligji;
e) kontrollon regjistrat e ndotësve, rregulloret e brendshme, teknike e teknologjike, dhe dokumentet e tjera qe lidhen me veprimtarinë dhe rrezikun e ndotjes;
e) vendos sanksione, sipas këtij ligji dhe akteve te tjera ligjore qe mbrojnë përbërës te veçante te mjedisit;
f) bën publike rezultatet për çdo kontroll te ushtruar .
2. Veprimtaria kontrolluese e Inspektoratit te Mjedisit pasqyrohet ne dokumente standarde te miratuara nga Ministri i Mjedisit.
3. Rregullat e hollësishme për funksionimin e Inspektoratit te Mjedisit përcaktohen nga Ministri i Mjedisit.

Neni 72
Mediet publike

Mediet publike ndihmojnë ne:
a) mbrojtjen e interesave kombëtare ne fushën e mjedisit;
b) rritjen e dijeve dhe te kulturës bashkëkohore për mjedisin;
c) realizimin e se drejtës te publikut për te marre te dhëna për gjendjen e mjedisit;
ç) përhapjen e arritjeve teknike dhe shkencore ne fushën e mjedisit dhe te veprimtarive kombëtare ne këtë fushe.

Neni 73
Organet e qeverisjes vendore

Organet e qeverisjes vendore përfaqësojnë strukturën me te rëndësishme shtetërore për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit, qe kane ne juridiksion, duke zbatuar përgjegjësitë, te drejtat e detyrat qe u jep ligji nr.8652, date 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore". Ne mbrojtje te mjedisit, ato kane për detyre:
a) te realizojnë zbatimin e ligjeve për mbrojtjen e mjedisit;
b) te hartojnë plane vendore për mbrojtjen e mjedisit dhe planet e rregullimit te territorit;
c) te bëjnë publike programet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit;
ç) te njoftojnë publikun për gjendjen e mjedisit dhe për veprimtaritë vendore, subjekte te vlerësimit te ndikimit ndaj mjedisit;
d) te nxisin e te mbështesin veprimtaritë e organizatave jofitimprurëse për mjedisin, duke tërhequr mendimin e tyre ne vendimmarrjet për mjedisin;

dh) te përcaktojnë vendet e grumbullimit e te përpunimit te mbeturinave prodhuese dhe jetësore, ne përputhje me kriteret mjedisore dhe planet e zhvillimit;
e) te organizojnë depozitimin e mbetjeve dhe te lendeve te rrezikshme dhe ruajtjen e zonave te gjelbra ne qendrat qytetëse dhe rreth tyre;
ë) te administrojnë mbeturinat qytetëse, impiantet e trajtimit te ujerave te ndotura dhe te mbeturinave te ngurta;
f) te disiplinojnë transportin dhe ndërtimet ne mjediset qytetëse.

Neni 74
Detyrat e institucioneve qendrore për mjedisin

Ne zbatim te këtij ligji, institucionet qendrore kane për detyre:
a) te integrojnë mbrojtjen e mjedisit ne politikat e strategjitë sektoriale, duke marre, përpara miratimit te tyre, edhe mendimin e Ministrisë se Mjedisit;
b) te bashkëpunojnë me Ministrinë e Mjedisit për hartimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor mjedisor, për futjen e teknologjive te pastra dhe me te mira te mundshme, për hartimin dhe zbatimin e strategjisë se mjedisit e planit përkatës te veprimit, për rehabilitimin e zonave te ndotura dhe te dëmtuara dhe për shkëmbimin e te dhënave për gjendjen e mjedisit;
c) te publikojnë te dhënat qe kane për mjedisin;
ç) te bashkëpunojnë me organet e qeverisjes vendore për zgjidhjen e problemeve te mjedisit;
d) te organizojnë zbatimin e programit kombëtar te monitorimit te mjedisit për personat juridike ne varësi te tyre.

Neni 75
Organizmat mjedisore ne organet shtetërore

1. Ne ministritë e linjës dhe ne organet e qeverisjes vendore ngrihen strukturat e mbrojtjes se mjedisit.
2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrive te linjës dhe te Ministrit te Mjedisit, miraton organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre organizmave.

Neni 76
Komitetet dhe grupet ndersektoriale kombëtare

1. Për hartimin dhe zbatimin e strategjive, te programeve dhe planeve kombëtare te veprimit për mjedisin ngrihen komitetet dhe grupet ndersektoriale, me përfaqësues te organeve qendrore, vendore, te institucioneve kërkimore-shkencore, te organizatave jofitimprurëse mjedisore dhe te organizatave profesionale te biznesit.
2. Ndërtimi, funksionimi dhe përgjegjësitë e komiteteve dhe grupeve caktohen me vendim te Këshillit te Ministrave.

KREU X

ROLI I PUBLIKUT

Neni 77
E drejta për marrjen e te dhënave mjedisore

1. Publiku dhe organizatat jofitimprurëse njoftohen për gjendjen e mjedisit nëpërmjet publikimit te te dhënave nga organet shtetërore dhe nga personat fizike e juridike, si dhe duke kërkuar te dhëna pranë organeve shtetërore.
2. Ministri i Mjedisit përcakton rregullat dhe procedurat për bërjen publike dhe shpërndarjen e te dhënave mjedisore nga organet e mbrojtjes se mjedisit.

Neni 78
Pjesëmarrja e publikut ne vendimmarrje për çështjet e mjedisit

1. Organet vendimmarrëse sigurojnë pjesëmarrje dhe rol aktiv te publikut dhe organizatave jofitimprurëse gjate procesit te vendimmarrjes.
2. Ministri i Mjedisit miraton rregullat e procedurat, qe realizojnë pjesëmarrjen e publikut ne vendimmarrjet e organeve te mjedisit.
3. Kushdo ka te drejte te ankohet tek organet shtetërore te mjedisit për çdo veprimtari qe përdor, kërcënon, dëmton dhe ndot mjedisin dhe te kërkojë mbylljen e saj ne rast rreziku. përveç marrjes se masave, këto organe i përgjigjen kërkesës brenda 1 muaji nga marrja e saj.
4. Ne kushtet e parashikuara nga ligji nr.7866, date 6.10.1994 "Për referendumet", publiku dhe organizatat jofitimprurëse kane te drejte te kërkojnë organizimin e referendumeve te përgjithshme ose te pjesshme për çështje te mjedisit.

Neni 79
Organizatat jofitimprurëse për mbrojtjen e mjedisit

1. Organizatat jofitimprurëse mjedisore gëzojnë te drejtat e oponencës dhe te bashkëpunimit me organet e mbrojtjes se mjedisit.
2. Ministri i Mjedisit përcakton rregullat dhe procedurat e detyrueshme për organet mjedisore, për te realizuar te drejtat e organizatave jofitimprurëse, sidomos:
a) ne hartimin e politikave, te strategjive, planeve te zhvillimit, si dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit;
b) ne hartimin dhe zbatimin e planeve te menaxhimit te zonave te ndryshme;
c) ne hartimin dhe zbatimin e programeve te monitorimit;
ç) ne kontrollet mjedisore;
d) ne procesin e vlerësimit te ndikimit ne mjedis dhe te miratimit te lejes mjedisore;
dh) ne hartimin e projektakteve normative mjedisore.
përfaqësues te organizatave jofitimprurëse marrin pjese si anëtarë ne këshilla e komitete, qe krijohen për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit.
3. Ministria e Mjedisit mbështet projektet e organizatave jofitimprurëse për mbrojtjen e mjedisit, sipas rregullave te miratuara nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit te Mjedisit.

Neni 80
Organizatat profesionale te biznesit

1. Organizatat jofitimprurëse profesionale te biznesit paraqesin pikëpamjet e veta ne rruge institucionale për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit. Ato marrin pjese ne hartimin dhe zbatimin e programeve te zhvillimit, te administrimit e te mbrojtjes se mjedisit.
2. Ministri i Mjedisit përcakton rregullat dhe procedurat për komunikimin e organeve publike mjedisore me organizatat profesionale te biznesit.

Neni 81

E drejta për padi gjyqësore

Ne rast kërcënimi ndaj mjedisit, ndotjeje dhe dëmtimi te tij, qytetari, publiku dhe organizatat jofitimprurëse kane te drejte:
a) t'u kërkojnë organeve shtetërore përkatëse marrjen e masave te duhura brenda afateve dhe ne përputhje me autoritetin qe u jep ligji;
b) te ngrenë padi ne gjykate, ne kushtet e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, kundër organit publik ose personit fizik e juridik, qe ka sjelle dëme ne mjedis ose qe rrezikon ta dëmtojë atë.

KREU XI

SANKSIONET

Neni 82

1. Kur shkeljet e këtij ligji përbejnë vepër penale, Inspektorati i Mjedisit bën kallëzim për ndjekje penale.
2. Shkeljet e mëposhtme, qe nuk përbejnë vepër penale, përbejnë kundërvajtje administrative ne fushën e mjedisit:
a) transportimi transit, pa leje, i mbetjeve dhe lendeve te rrezikshme përmes territorit dhe ujerave territoriale e te brendshme te Republikës se Shqipërisë;
b) importimi i mbetjeve dhe lendeve te rrezikshme për ruajtje, depozitim ose asgjësim;
c) shkelja e rregullave te caktuara te sigurimit gjate transportimit transit te mbetjeve e te lendeve te rrezikshme;
ç) mosdergimi ose mosparaqitja ne afat e te dhënave për gjendjen e mjedisit;
d) mosshoqerimi i te dhënave për gjendjen e mjedisit me rekomandimet për mënyrën e veprimit te shtetasve ne rast parashikimi te pasojave negative për mjedisin;
dh) mosnjoftimi i popullsisë nga personat fizike e juridike për shkaktimin e ndotjes ose dëmtim te mjedisit prej tyre, për masat e marra për kufizimin ose zhdukjen e ndotjes, si dhe për mënyrën e veprimit te shtetasve;
e) mosnjohja e blerësve ose e konsumatoreve me te dhënat përkatëse për mallrat dhe shërbimet qe janë te rrezikshme dhe për pasojat ose ndikimet negative te mundshme;
ë) kundërshtimi ose shmangia e personave fizike e juridike për kryerjen e verifikimit mjedisor, kur ky është urdhëruar nga Ministri i Mjedisit;
f) shkelja nga specialistet e procedurës se vlerësimit te ndikimit ne mjedis;
g) ushtrimi pa leje mjedisore i veprimtarive ekonomike e shoqërore, qe mund te ndikojnë ne mjedis;
gj) shkelja e rregullave dhe udhëzimeve te caktuara nga Ministri i Mjedisit për zona me mjedis veçanërisht te rrezikuar;
h) tejkalimi i kufijve te lejueshëm te lendeve ndotëse;
i) shkelja e rregullave për grumbullimin, depozitimin, ruajtjen, transportimin dhe sistemimin e mbetjeve dhe te lendeve te rrezikshme, te caktuara nga Ministri i Mjedisit;
j) braktisja e veprimtarive, instalimeve, impianteve dhe mosberja e rregullimeve për te sjelle ne gjendjen e mëparshme mjedisin ose mossigurimi i kushteve për rehabilitimin e mjedisit, pas përfundimit te veprimtarisë;
" k) mosrespektimi i detyrimeve gjate vënies ne pune te instalimeve dhe te veprimtarive.

Neni 83

1. Për kundërvajtjet administrative te parashikuara ne nenin 82 te këtij ligji, jepen dënime me gjobe si me poshtë:
a) për shkronjat "a", "b", "c" dhe "i" nga 500000 deri ne 1000000 leke;
b) për shkronjat "g", "gj", "h", "j" dhe "k" nga 300000 deri ne 500000 leke;
c) për shkronjat "ç", "d", "dh", "e", "e" dhe "f", nga 10000 deri ne 300000 leke.
2. Krahas dënimit me gjobe, vendoset edhe sekuestrimi i mjeteve e lendeve qe shkaktojnë ndotje dhe dëmtim te mjedisit dhe, ne varësi nga ndotja dhe dëmtimi i shkaktuar, vendoset edhe heqja e përhershme ose e përkohshme e lejes mjedisore. Ne çdo rast kundërshtimi për zbatimin e masave te mësipërme, Inspektorati i Mjedisit bashkëpunon me Policinë e Shtetit.

Neni 84

1. Te drejtën e gjobës për kundërvajtjet administrative, te parashikuara ne nenin 83 te këtij ligji, e ka Inspektorati i Mjedisit.
2. Kundër vendimit te dënimit mund te behet ankim, brenda 10 ditëve nga njoftimi i tij, te Ministri i Mjedisit, i cili duhet t'i përgjigjet ankimit brenda 15 ditëve nga depozitimi i tij.
3. Kundër vendimit te Ministrit te Mjedisit ose kur ky i fundit nuk përgjigjet brenda afatit 15-ditor, mund te behet ankim, brenda 5 ditëve, ne Gjykatën e Rrethit te Tiranes.

Neni 85

Gjobat për kundërvajtjet administrative, sipas këtij ligji, derdhen ne llogarinë e te ardhurave te Buxhetit te Shtetit dhe likuidohen brenda 30 ditëve nga dita e vendimit te formës se prere. për çdo dite vonese, pas plotësimit te këtij afati dhe deri ne një afat prej 30 ditësh, kundërvajtësi detyrohet te paguaje, përveç gjobës, një shume te barabarte me 10 për qind te gjobës.

Neni 86

1. Ndaj subjektit qe nuk zbaton tërësisht dhe ne afatet ligjore masat dhe sanksionet e vendosura nga Inspektorati i Mjedisit, si dhe ndaj subjektit qe, brenda vitit kalendarik, përsërit te njëjtën shkelje, Kryeinspektori ose Ministri i Mjedisit urdhëron pezullimin ose mbylljen e përhershme te veprimtarisë, ne varësi te rrezikshmërisë qe paraqet për mjedisin dhe shëndetin.
2. Kundër vendimeve për pezullimin dhe mbylljen e veprimtarisë nga Kryeinspektori ose nga Ministri i Mjedisit, mund te behet ankim ne gjykatën e rrethit brenda 5 ditëve nga data e marrjes se njoftimit.

Neni 87
Fondet e mjedisit

1. Te ardhurat nga gjobat përdoren si mbështetje financiare për veprimtaritë e mëposhtme:
a) për zhdukjen e burimeve te ndotjes dhe dëmtimit;
b) për hartimin e projekteve te riaftësimit ne zonat ekologjikisht te dëmtuara dhe te ndotura;
c) për pune kërkimore-shkencore, për kryerjen e studimeve dhe kualifikimin e personelit;
ç) për shpërblimin e punonjësve te mjedisit, te specialisteve dhe institucioneve te fushave përkatëse, qe kryejnë shqyrtimin e dokumentacionit te vlerësimit te ndikimit ne mjedis;
d) për te përballuar shpenzimet administrative për kontrollin, vlerësimin e ndikimit ne mjedis dhe programet e monitorimit.

2. Te ardhurat nga tarifat e shërbimeve përdoren sipas udhëzimit te përbashkët te Ministrit te Financave dhe Ministrit te Mjedisit,

Neni 88
Akte te tjera te nevojshme

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave te nxjerre aktet nënligjore ne zbatim te neneve 17 pika 2, 22 pika 2,31 pika 2,36 pika 1, 53 pika 8,68 pika 4,69 pika 3,70 pika 6,75 pika 2,76 pika 2 dhe 79 pika 3 te këtij ligji.
2. Ngarkohet Ministri i Mjedisit qe te nxjerre urdhrat dhe udhëzimet ne zbatim te neneve 13 pika 2, 15 pika 3, 43 pika 2, 47 pika 2, 50 pika 4, 55 pika 2, 63 pika 2, 71 pikat 2 dhe 3, 77 pika 2, 80 pika 2 dhe 87 pika 2 te këtij ligji.

Neni 89
Shfuqizime

Me hyrjen ne fuqi te këtij ligji, ligjet nr.7664, date 21.1.1993 "Për mbrojtjen e mjedisit", nr.8364, date 2.7.1998 "Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.7664, date 21.1.1993 "Për mbrojtjen e mjedisit"", nr.8825, date 5.11.2001 "Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.7664, date 21.1.1993 "Për mbrojtjen e mjedisit"", si dhe çdo akt tjetër normativ, qe bie ne kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 90

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3490, date 9.10.2002 te Presidentit te Republikës se Shqipërisë, Alfred Moisiu.